

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-107/12

**Prishtinë,
1 tetor 2013**

Në çështjen juridike të:

R.A.

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kundër

A. M.

Pala përgjegjëse në kërkesë/ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët: Elka Filcheva- Ermenkova , Kryetare e Kolegjit ,Esmë Ertezi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/145/2012 (dosja e rastit është regjistruar në AKP me numrin KPA44455) i datës 29 shkurt , 2012, pas vendimmarrjes të mbajtur më 1 tetor 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e R. A. e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/145/2012, të datës 29 shkurt 2012 ,sa i përket ankesës ë regjistruar në KPA me numrin KPA 44455.**
- 2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/R/145/2012 të datës 29 shkurt 2012, sa i përket ankesës ë regjistruar në KPA me numrin KPA 44455.**
- 3. Obligohet pala ankuese që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej 60 (gjashtë dhjetë) euro, në afatin prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh ,nga data e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 06 Korrik 2007, R. A. e ka paraqitur kërkesën në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri posedimin e pronës-banesës që gjendet në Suharekë, rruga e Karagjorgjeviqit nr.110,hyrja e tretë, banesa nr.6 kati dytë . Ai pretendon se ka qenë pronar i kësaj banese sipas kontratës së blerjes së banesës të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë Vr.nr 12/99 i dt. 18 mars 1999.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një kopje të kontratës midis palëve dhe një sërë dokumentesh tjera, por që nuk janë relevante për këtë çështje juridike.

Sipas kopjes së kontratës, kontrata e blerjes së banesës është vërtetuar në Gjykatën Komunale në Suharekë Vr.nr 12/99 i dt. 18 mars 1999,; sidoqoftë ajo nuk është gjetur në arkivin e kësaj gjykate dhe se kjo kontratë me këtë numër nuk ekziston në regjistrat e kontratave të shitblerjes.

Kërkesa është regjistruar me numër KPA44455.

Më 07 korrik 2008, zyrtarët e AKP-së shkuan te vendi ku ndodhej objekti banesor dhe konstatuan që ai shfrytëzohej nga N. M. vëllai i palës përgjegjëse në kërkesë i cili ka kërkuar të drejtën ligjore duke nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes.

Me dt.05 shkurt 2009 pala përgjegjëse në kërkesë duke marr pjesë në procedurën e AKP-ës ka pretenduar të drejtën ligjore të kësaj banese.

Për ta mbështetur pretendimin e tije A. M. ka paraqitur këto dëshmi edhe atë:

- Kontratën e blerjes së banesës nr. 6 që gjendet në ndërtesën banesore 43 në Suharekë rr.Car Dushani , të lidhur në mes të Qendrës Shëndetësore në Prizren si shitës dhe tij si blerës me nr. 11/384 i dt.06 shtator 1993;
- Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Suharekë C.nr.15/97 të dt.16 dhjetor 1997,me të cilin aktvendim është konstatuar se Komuna e Suharekës palën përgjegjëse në kërkesë e ka larguar me dhunë nga banesa që është objekt i kërkesës dhe ky organ ka qenë i obliguar që t'ia kthej atij posedimin në banesë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm;
- Me vendimin e HPCC/D/222/A&c i dt.22 tetor 2005 A. M. në cilësinë e paraqitësit të kërkesës së kategorisë A i pranohet e drejta pronësore në banesën që është objekt i kërkesës. Ndërkaq R. A.si paraqitës i kërkesës për të njëjtën banesë është refuzuar; dhe
- Me vendimin e HPCC/REC/81/2006,i dt. 11 dhjetor 2006, kërkesa për rishqyrtim e R. A. kundër vendimit të HPCC/D/222/A&c i dt.22 tetor 2005 është refuzuar si e pabazuar.

Sipas raportit verifikues i dt.24 maj 2011 të gjitha dokumentet e theksuara janë verifikuar pozitivisht nga ekipi verifikues i AKP-ës.

Më 29 shkurt 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KPCC) me vendimin e tij KPPC/D/R/145/2012, e hodhi poshtë kërkesën e R. A. si çështje e gjykuar apo res judicata. Kjo me arsyetim se e njëjta kërkesë e tije e regjistruar në HPCC nr.DS 6066382, është shqyrtuar dhe vendosur me vendimin e formës së prerë të HPCC/D/222/A&c i dt.22 tetor 2005.. Ndërkaq , kërkesa e palës përgjegjëse A. M. është pranuar sipas nenit 14.4.C të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Më 23 korrik 2012, vendimi iu dorëzua R. A. dhe i njëjti ushtroi ankesë në Gjykatë Supreme me 15 gusht 2012.

Me 26 qershor 2012 vendimin e pranoi A. M. pala (tani e tutje: pala përgjegjëse në kërkesë), dhe përmes avokatit të tij me datë 01 tetor 2012 ai ka paraqitur përgjeje në ankesë.

Paraqitësi i ankesës e kundërshton vendimin ankimor për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit material. Ai pretendon se ka qenë posedues i ligjshmen i banesës së theksuar dhe se të njëjtën e ka humbur për shkak të konfliktit të armatosur në Kosovë në periudhën 1998/1999.

Pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta anulojë vendimin e KPCC-së sa i përket rastit në fjalë dhe ta kthejë rastin në KPCC, ose ta rishikojë vendimin dhe t'i pranoj të drejtat e palës ankuese për kthim posedim të banesës që është objekt i kërkesë dhe të kompensimit të sajë sipas programit për kompensim.

Pala përgjegjëse në ankesë pretendon se vendimi ankimor është i drejtë dhe i ligjshëm, ndaj edhe propozon Gjykatës Supreme të njëjtën ta konfirmojë. Ai ka theksuar se KPCC-ja, drejtë ka vepruar kur ka hedh kërkesën e ankuesit me arsyetim të drejtë dhe të ligjshëm ngase për të njëjtën çështje në mes të njëjtave palë është vendosur me vendimin e plotfuqishëm dhe formës së prerë të HPCC/D/222/2005/AC, i dt.22 tetor 2005.Me këtë vendim palës përgjegjëse në ankesë i është pranuar e drejta pronësore në banesën që është objekt i kërkesës dhe e njëjta i është kthyer në posedim. Ndërkaq palës ankuese i është refuzuar kërkesa për riposedim.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Pas shqyrtimit të shkresave të lendes, pretendimeve ankimore ,sipas dispozitave të nenit 194 të LPK-ës Gjykata Supreme gjeti se: ankesa është e pabazuar.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimi ankimor është i drejtë dhe ligjshëm. Drejtë ka vepruar KPCC kur ka hedhur kërkesën e R. A. për shkak të çështje së gjykuar apo res judikata sipas nenit 14.4.C të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, KPCC. Kërkesa e ankuesit është shqyrtuar dhe vendosur me vendimin e plotfuqishëm dhe formës së prerë të HPCC/D/222/2005/AC, i dt.22 tetor 2005 .

Me vendimin e HPCC-ës palës përgjegjëse në ankesë i është pranuar e drejta pronësore në banesën që është objekt i kërkesës dhe e njëjta i është kthyer në posedim. Ndërkaq, palës ankuese i është refuzuar kërkesa për ri posedim.

Pretendimet e palës ankuese janë shqyrtuar, vendosur me refuzimin e kërkesës së tije me vendimin HPCC/D/222/2005 i dt. 22 tetor 2005 i cili vendim është res judicata apo çështje e gjykuar. Sipas nenit 166 të LPK-ës i cili mutatis mutandis zbatohet sipas nenit 13.5 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, nuk lejohet gjykimi i ri në mes palëve të njëjta për çështjen juridike, për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, siç është rasti konkret.

Vendimi ankimor nuk përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtë materiale dhe procedurale.

Rrjedhimisht mbi të mësipërmen e me zbatim të nenit 13.3.B të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenit 166 par 2 të LPK-ës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Prandaj zbatohet, tarifa e pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.15, 10.21 dhe 10.1 UA 2008/2): 30 €.

Këto tarifa gjyqësore paguhen nga pala gjyqëhumbëse. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë është jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë dhe jo më gjatë se 90 (nëntëdhjetë) ditë. Gjyqi e cakton afatin prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh. Neni 47 paragrafi 3 parashikon që në rast të mospagesës së tarifës brenda afatit, pala duhet të paguaj gjobën prej 50% të shumës së tarifës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të caktuar, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

***Elka Filcheva Ermenkova*, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

***Esmat Erterzi*, Gjyqtare e EULEX-it**

***Sylejman Nuredini*, Gjyqtar**

***Urs Nufer*, Referent i EULEX-it**